



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-D/DPK
Dep. 01-2678/14
Nr. i faq. 02
Broj stranica 02
Nr. pages 02

Nr. Prot. 01-2678/14
Br. Prot. 01-2678/14
Prot. No. 01-2678/14

Data 18.07.2014
Datumi 18.07.2014
Date 18.07.2014



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 14.07.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-2007/14, për z. Bajram Baftiri – Anëtar i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik, nr. AKK – 03-2007/14, për z. Bajram Baftiri – Anëtar i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat N.SH. “ENGLISH LANGUAGE CENTER”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyrtarit të lartë z. Baftiri, së pari i është bërë shkresa zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për njoftimin e fillimit të procedurës së shqyrtimit të gjendjes së Konfliktit të Interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese, ai është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë dhe i është sqaruar situata në të cilën ndodhet.

Pasi që është bindur për ndryshimet që duhet t'i bëj, ai ka pranuar rekomandimin e Agjencisë, që të autorizoj një person të besueshëm për të udhëhequr biznesin privat, në mënyrë që të shmangët situata e mundshme e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, i njëjti ka dërguar në Agjencinë kundër Korrupsionit shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03 - 2568/14) me të cilën dëshmohet se në

biznesin privat N.SH. "ENGLISH LANGUAGE CENTER", ka autorizuar një person të besueshëm për ta menaxhuar. Me këto ndryshime, zyrtari i lartë z. Bajram Baftiri, ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

